



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.326/3 Prot

Tiranë, më 16.3.2023

VENDIM

Nr.06, datë 16.3.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 326 Prot., datë 09.02.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës për informacion depozituar datë 19.01.2023, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni si vijon:

- *Listën me targat e automjeteve në pronësi të institucioneve dhe autoriteteve publike në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të atyre në pronësi të Gardës së Republikës dhe Ministrisë së Brendshme.*

Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 09.02.2023, ka kthyer përgjigje në lidhje me kërkesën për informacion, duke cituar se: “...për nxjerrjen e informacionit të kërkuar, afati ligjor, referuar nenit 15 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është i pamjaftueshëm për shkak se të dhënat të cilat do të përpunohen nga ai, janë të konsiderueshme. Gjithashtu, informacioni i kërkuar jepet kundrejt pagesës 200 lekë për secilin mjet që do të rezultojë nga kërkimi. Ky informacion do të përpunohet pas konfirmimit për kryerjen e pagesës.”

Në vijim, pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi pretendon se: *“...tarifa e vendosur nga Autoriteti Publik është në kundërshtim me nenin 13 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”*”.

Në këto kushte, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 19.01.2023.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim, “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të LDI, në të cilin parashikohet se: *“...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”*, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me datë 17.02.2023, me prezencën e ankuesit dhe përfaqësuesëve të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në ankesë, duke kërkuar vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit përkatës, sipas kërkesës për informacion, depozituar datë 19.01.2023.

Në vijim, nga ana e Zyrës së Komisionerit, u pyetën përfaqësuesit e Autoritetit Publik nëse informacioni i kërkuar disponohet elektronikisht nga ai, për t’u vendosur në dispozicion në këtë mënyrë për ankuesin.

Përfaqësuesit e Autoritetit Publik u shprehën se sistemi elektronik nuk i ka të ndara subjektet në individ, institucion etj, në këto kushte duhet bërë një verifikim nga ana e tyre. Gjithashtu, vendosën në dispozicion për Zyrën e Komisionerit, një relacion shpjegues, ku ndër të tjera sqarohet se: *“...Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”, shprehet bashkëpunuese për ta dhënë informacionin konform LDI, por kundrejt tarifës 200 lekë për çdo konfirmim si dhe duke marrë konsideratë nenin 16 të LDI për kërkesat me kosto të lartë dhe që kërkojnë më shumë kohë se afati i zakonshëm. Për sa më sipër, lidhur me përcaktimin e tarifave të aplikueshme për marrjen e informacionit objekt ankese, DPSHTRR i është drejtuar me shkresën zyrtare me nr. 499 Prot., datë 02.04.2001, Ministrisë së Transportit për miratimin e tarifës së shërbimit. Kjo kërkesë është përsëritur me shkresën nr. 499/2 Prot., datë 21.06.2001. Me shkresën nr.1240/3 Prot., datë 31.07.2001, Ministria e Transportit miratoi tarifën e shërbimit për “Konfirmime të ndryshme” në vlerën 200 lekë. Tarifa këto që janë publike në faqen e webit zyrtar të DPSHTRR-së”*.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Zyra e Komisionerit i la detyrë përfaqësuesëve të Autoritetit Publik, për të përcjellë qëndrimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje, brenda datës 22.02.2023.

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 22.02.2023, rikonfirmoi qëndrimin e reflektuar në aktet shkresore të trajtuara më sipër, duke cituar ndër të tjera se: *“...është vijuar nga specialisti përkatës kryerja e shërbimit “konfirmime të ndryshme” duke përpunuar sipas objektit të kërkesës së organizatës të dhënat e targave të mjeteve në pronësi të institucioneve publike. Në zbatim të nenit 15, të LDI specialistit që përpunon informacionin për të përmbyllur materialin i duhen edhe 8 ditë shtesë filluar nga data e sotme 22.02.2023.*

Gjithashtu, në zbatim të nenit 16 të LDI, DPSHTRR ka një kosto të miratuar për dhënien e këtij shërbimi sipas asaj që u deklarua dhe u vërtetua me dokumentacionin përkatës edhe në seancën dëgjimore. Tarifa për marrjen e këtij shërbimi është 200 lekë me TVSH, mbi konfirmimet për secilin institucion apo autoritet publik, për mjetet rrugore në pronësi të tyre.”

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, nëpërmjet e-mail-it datë 24.02.2023, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 326/2 Prot., datë 27.02.2023, ka vijuar me ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion informacionin/dokumentacionin sipas kërkesës për informacion me pretendimin se: *“DPSHTRR-ja fillimisht ka mbajtur një qëndrim të tillë duke kërkuar NUIS/NIPT e autoriteve publike dhe duke mos përmendur kostot e ofrimit të informacionit. Më pas, kur DPSHTRR-së i janë përcjellë NUIS/NIPT-et e organeve publike nga ana e Qendrës “Qëndresa Qytetare”, DPSHTRR-ja është shprehur se informacioni i kërkuar mund të jepet kundrejt vlerës 200 ALL/për targë. Aktualisht, qëndrimi i organit publik ka ndryshuar sërish. Në kushtet kur nuk plotësohen kushtet për ekzistencën e një tarife, atëherë qëndrimi i DPSHTRR-së është i pabazuar në ligj dhe në prova, dhe për rrjedhojë Komisioneri duhet të vendosë pranimin e ankimit tonë, sipas objektit të tij të plotë...”*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik në lidhje me tarifat për marrjen e dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Autoriteti Publik deklaron se, mbështetur në pikën 1 të nenit 223 të Kodit Rrugor, në të cilën përcaktohet se: *“1. Ministria që mbulon veprimtarinë përkatëse të përcaktojë tarifat për kryerjen e shërbimeve që lidhen me zbatimin e kompetencave në fushën e motorizimit civil. Veprimtaria financiare e organeve përkatëse të ministrisë që mbulon veprimtarinë përkatëse është me vetëfinancim”*, me shkresën nr. 1240/3 Prot., datë 31.7.2001, Ministria e Transportit (ministria që ka mbuluar këtë veprimtari asokohe) e ka kategorizuar këtë shërbim në zërin *“konfirmime të ndryshme”* dhe për të është përcaktuar një tarifë prej 200 lekësh.

Referuar kërkesës për informacion, konstatohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me një kërkesë e cila konsiston në vënien në dispozicion të *Listës me targat e automjeteve në pronësi të institucioneve dhe autoriteteve publike në Republikën e Shqipërisë...*, informacion ky që në parim përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, tarifat e miratuara me shkresën e sipërcituar nuk mund të gjejnë zbatim për rastet kur kërkohet informacion publik, por, në rastet kur ofrohet një shërbim i caktuar i cili shoqërohet me vërtetimin përkatës në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale të Autoritetit Publik.

Ndërkohë, dhënia e informacionit publik nuk mund të konsiderohet shërbim i ofruar nga Autoriteti Publik në kuadër të detyrave të tij funksionale, por përmbushje e detyrimeve që burojnë nga LDI dhe baza ligjore që rregullon tarifat për dhënie informacioni publik është neni 13 i këtij ligji, ku ndër të tjera parashikon se: *“1. Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë. Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike jepet falas. 2.Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg. 3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrton periodikisht, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, tarifat e bëra publike nga autoritetet publike dhe, sipas rastit, urdhëron ndryshimin e tyre.”*

Gjithashtu, nga shqyrtimi i kërkesës për informacion, konstatohet se kërkuesi/ankuesi ka përcaktuar se informacioni mund t’i vendoset në dispozicion edhe në rrugë elektronike. Në këto kushte, duke qenë se dokumentacioni i kërkuar disponohet elektronikisht ose mund të konvertohet nga Autoriteti Publik, ai në përputhje me shkronjën b) të pikës 2 të nenit 14 të LDI duhet ta vendosë atë në dispozicion nëpërmjet postës elektronike pa aplikuar tarifat e cituara.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

Kërkuesi/ankuesi, është përfaqësues i një organizatë jo qeveritare, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat

vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqëror”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”*.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 326 Prot., datë 09.02.2023, nga Organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit përkatës sipas kërkesës për informacion depozituar datë 19.01.2023, konkretisht: *“Listën me targat e automjeteve në pronësi të institucioneve dhe autoriteteve publike në Republikën e Shqipërisë, me përjashtim të atyre në pronësi të Gardës së Republikës dhe Ministrisë së Brendshme”* brenda datës 24.3.2023.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 16.3.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi